



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

PËR

PROJEKT RREGULLORE Nr. X/2024 PËR PROCEDURËN DISIPLINORE PËR NËPUNËSIT NË ADMINISTRATËN E SISTEMIT GJYQËSOR

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Projekti i Rregullore Nr. X/2024 për Procedurën Disiplinore për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor synon të përcaktojë procedurën disiplinore për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor, përfshirë hetimin administrativ disiplinor nga Njësia, themelimin e komisionit disiplinor, përbërjen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të tij, masat disiplinore, si dhe mjetet e lejuara për ankim për të punësuarit me rastin e shqiptimit të masave disiplinore. Procedura disiplinore aplikohet për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të të punësuarit

Kjo projekt rregullore synon që dispozitat e saj të aplikohen për të gjithë të punësuarit në administratën gjyqësore, duke përfshirë njësit e Këshillit, PZAP dhe Gjykatat. Përrjashtimisht nga kjo, dispozitat nuk do të zbatohen për të punësuarit për të cilët Këshilli ka paraparë rregullim të veçantë të procedurës disiplinore.

Gjithashtu, me këtë projekt rregullore përcaktohen parimet e procedurës

	<p>disiplinore, shkeljet dhe masat disiplinore, si dhe fillimi, inicimi dhe paraqitja e një rasti disiplinor. Po ashtu, përcaktohet forma e kërkesës, marrëveshja për pranimin e përgjegjësisë disiplinore, si dhe kompetencat e komisionit disiplinor, duke përfshirë seancën e komisionit dhe nxjerrjen e vendimit disiplinor.</p> <p>Projekt rregullorja, gjithashtu përcakton edhe personat kompetent për caktimin e masave disiplinore, parashkrimin dhe fshirjen e masave disiplinore si dhe të drejtën e ankesës për palën e pakënaqur ndaj shqiptimit të masave disiplinore.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Iniciativës për hartimin e projektit të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor i kanë paraprirë kërkesa e Këshillit për auditimin e procedurës disiplinore të nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor nga Komisioni për Administrimin e Gjykatave, si dhe autorizimet ligjore që burojnë nga legjislacioni në fuqi, si Ligji për Zyrtarët Publik dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.</p> <p>Pas auditimit të procedurës disiplinore për nëpunësit e administratës së sistemit gjyqësor nga Komisioni për Administrimin e Gjykatave, është vërejtur një ngecje në procedurat hetimore dhe vendimmarrëse. Komisioni ka dhënë disa rekomandime, sipas të cilave Këshilli ka vendosur për hartimin e kësaj projekt rregullore me qëllim të përcaktimit të procedurave të qarta dhe standarde.</p>

	<p>Projekti i rregullores synon të krijojë procedura disiplinore efikase dhe efektive për nëpunësit në administratën e sistemit gjyqësor, duke përcaktuar një procedurë standarde të hetimit disiplinor dhe zhvillimit të fazave të procedurës disiplinore, e cila ndryshon nga procedura disiplinore e cila është duke u zhvilluar aktualisht.</p> <p>Hartimi i këtij akti është i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme:</p> <p>Së pari, përcakton një zhvillim të procedurës disiplinore të standardizuar, efektive dhe efikase, duke përcaktuar në mënyrë specifike masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen për nëpunësit në administratën e sistemit gjyqësor dhe rrjedhën e procedurës disiplinore në tërësi.</p> <p>Së dyti, përcakton përgjegjësitë dhe krijon komision të specializuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e fakteve dhe provave të cilat paraqiten kundër subjektit i cili është pjesë e hetimit disiplinor.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të projekt Rregullores për Procedurën Disiplinore për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është shtatë (7) ditë kalendarike, deri më 10 prill 2024.</p>

	<p>Edhe pse kjo projekt rregullore ka kaluar një fazë të mëparshme të konsultimit publik, për shkak të ndryshimeve në ligje, veçanërisht Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, drafti është rishikuar për t'u përshtatur me legjislacionin aktual. Për këtë arsye, Këshilli ka vendosur që drafti të nënshtrohet përsëri periudhës së konsultimit.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>